


RAPORT VJETOR

PROJEKTET E REALIZUARA 2015



**Qendra për zhvillim
të rajonit planor Jugperëndimor**



Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor



RAPORT VJETOR
projektet e realizuara 2015



Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor

Udhëheqëse: Mirjana LOZANOSKA

Koordinator: Stojan SAVESKI

Adresa: Partizanska p.n. K.P. 27, 6330, Strugë

Telefoni për kontakt: 046 701 005, 701 055

e-mail: CRJ@southwestregion.mk

Botoi: EVROPA 92 Koçan

Strugë, 2016

Publikimi është botuar me mbështetjen e Agjencisë Zvicerane për bashkëpunim dhe zhvillim (SDC) dhe Shoqërisë Gjermane për bashkëpunim ndërkombëtar (GIZ)



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



германска
соработка

DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Realizuar nga:

giz

Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Programi për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor (2015-2019) është dokument planor afatmesëm i përgatitur në bazë të Ligjit për zhvillim të barabartë rajonal, me qëllim të sigurojë zhvillim të qëndrueshëm të Rajonit përmes shfrytëzimit të potencialeve në dispozicion të tij, si dhe të kontribuojë në uljen e pabarazive me rajonet tjera planore dhe inter corporis (mes trupave).

Operacionalizimi i Programit në nivel vjetor kryhet përmes Planit aksionar, me realizimin e të cilit, më saktësisht, realizohen qëllimet dhe prioritetet e përcaktuara në këtë dokument programor, përkatësisht në sferën ekonomike, infrastrukture dhe arsimore-sociale, si dhe në atë të turizmit, kulturës dhe zhvillimit rural në RPJP.

Në periudhën të cilën e përfshin ky raport, Qendra për zhvillim realizoi projekte rajonale të financuara përmes Programit për zhvillim të barabartë rajonal të Ministrisë për vetëqeverisje lokale dhe Byrosë për zhvillim rajonal, Skema për mbështetje financiare të palëve të treta përmes GIZ RED Programit dhe Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shkup, përmes Programit për zhvillim të Kombeve të Bashkuara UNDP, Programit për bashkëpunim ndërkuftar mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë dhe pjesëmarrjes në realizimin e dy projekteve të mëdha rajonale të financuara nga IPA3 komponenti për Zhvillim rajonal të Bashkimit Evropian



Brendimi i prodhimeve tipike qumështore në mikro rajonin e Dibrës

► Qëllimi afatmesëm I nga Programi për zhvillim të RPJP

■ Masa 1.1.5 Brendimi i Rajonit dhe prodhimeve kryesore

Në kuadër të projektit, përmes Entit për përkatësi industriale të RM, në janar të viti 2015, u regjistrua marka kolektive tregtare “Djathi Dibran”. Vendimi iu dorëzua Shoqatës për ruajtjen e dhene “DASHI” nga Dibra në të cilën janë anëtar numri më i madh i prodhuesve të djathit nga mikro rajoni i Dibrës dhe i Qendrës Zhupë. Pranim-dorëzimi i Vendimit u bë në një ngjarje promovuese që u mbajt në hotelin Drim në Strugë në 10.06.2015. Sipas ruajtësve të dhene nga ky rajon, nga qershori i vitit 2015 deri më tani, duke iu falënderuar “markës kolektive tregtare”, shitja e “Djathit Di-



bran” dukshëm është rritur. Ky është një tregues i rëndësishëm se projekti që në fillimet e tij, i arriti qëllimet e vendosura.

Rezultatet dalëse:

- Vendimi i marrë për markën kolektive tregtare “Djathi Dibran”;
- Ceremonia dhe promovimi i organizuar për “markën kolektive tregtare”;
- Vendimi i dhënë për MKT ruajtësve të dhenve, dhe
- Rritja e shitjeve të “Djathit Dibran” për 20%.



Përgatitja e dokumentacionit teknik dhe ndërtimi i sistemit për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të zeza në Kërçovë

- ▶ Qëllimi afatmesëm IV nga nga Programi për zhvillim
- **Masa 4.1.3 Sistemet e bartjes së ujërave të zeza komunale dhe stacionet e pastrimit**

Qendra për zhvillim të RPJP, vitet e kaluara, përgatiti Studim për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të zeza në mikro rajonin e Kërçovës me mbështetje financiare nga Qeveria e RM, përmes Programit për ZHBR. Gjithashtu, me mbështetje të GIZ RED dhe Agjencisë zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim u përgatit edhe Analiza e shpenzimeve dhe përfitimeve për sistemin e grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të zeza. Të dy dokumentet janë përgatitur sipas standardeve të BE, dhe të njëjtat janë përkthyer edhe në gjuhën angleze.



Në bazë të këtyre dokumenteve, të cilat u prezantuan dhe dorëzuan në Ministrinë e ambientit jetësor dhe planifikimit hapësinor, janë miratuar 10 milion € nga Delegacioni i BE në Maqedoni, përmes IPA3 Komponentit për zhvillim rajonal. Me mjetet u përgatit edhe dokumentacioni teknik plotësues i nevojshëm, me çka u qas drejt ndërtimit të sistemit.

Qendra për zhvillim të RPJP është pjesë e grupit punues për zbatim, dhe në mënyrë aktive merr pjesë në takimet punuese të grupit të ekspertëve bashkë me pjesëmarrësit nga Komuna e Kërçovës dhe ndërmarrjet publike. Sipas dinamikës së realizimit të projektit sistemi për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të zeza në Kërçovë duhet të lëshohet në përdorim deri në fund të vitit 2017.

Rezultatet dalëse:

- Dokumentacion teknik i përgatitur në pajtim me standardet e BE;
- Dokumentacioni i tenderimit i përgatitur për ndërtimin e sistemit;
- Procedura e realizuar e tenderimit për ndërtimin e sistemit;
- Të realizuara detyrimet e marra nga ana e komunës së Kërçovës (eksproprijimi i tokës);
- Të organizuara pesë takime pune në Kërçovë me përfaqësues të ekipit të ekspertëve, MAJPH, Komuna e Kërçovës, dhe
- Marrëveshja e nënshkruar në mes MAJPH dhe Komunës së Kërçovës



Dokumentacion teknik për mbindërtimin e SPUZ Vranishtë, zgjerimi i sistemit të kolektorit për mbrojtjen e Liqenit të Ohrit dhe ndarjen e ujërave të zeza nga ato atmosferik në qytetin e Ohrit dhe Strugës

- Qëllimi afatmesëm IV nga Programi për zhvillim
- **Masa 4.1.3 Sistemet e bartjes së ujërave të zeza komunale dhe stacionet e pastrimit**

Qendra për zhvillim të RPJP, në periudhën e kaluar, përgatiti Studim për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të zeza përgjatë Drinit të Zi (Strugë-Dibër), Studim për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të zeza nga Gradishtë në Shën Naum (Ohër), Projekt themelor për ndërtimin e kolektorëve nga Kalishta deri në Radozhdë (Strugë) dhe Projekt themelor për kanalizim fekal në Vevçan dhe Strugë, me financim nga Qeveria e RM, përmes Programit për ZHBR, dhe mjete nga donatori GIZ RED dhe Agjencia zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC).



Dokumentet e përgatitura janë në nivele të larta teknike dhe në pajtim me direktivat e BE, dhe të njëjtat u dorëzuan dhe prezantuan në Ministrinë e ambientit jetësor dhe planifikimit hapësinor. Në bazë të këtyre dokumenteve, janë miratuar 10 milion € nga Delegacioni i BE në Maqedoni, përmes IPA3 Komponentit për zhvillim rajonal, me të cilat u përgatit edhe dokumentacioni i nevojshëm shtesë. Në fazën e dytë duhet të qaset drejt mbindërtimit të stacionit pastrues në Vranishtë (Strugë), ndërtimit të kolektorit perëndimor nga Kalishta deri në Radozhdë dhe ndarjes së kanalizimit fekal nga ai atmosferik në Ohër dhe Strugë.

Qendra për zhvillim të RPJP është pjesë e grupit punues për realizimin e këtij projekti dhe merr pjesë aktive në takimet e punës, bashkë me ekipin e ekspertëve dhe përfaqësuesit e MAJPH, komunitet e Ohrit, Strugës dhe Vevçanit dhe ndërmarrjet e tyre publike. Në pajtim me dinamikën e planifikuar mbindërtimi i SPUZ në Vranishtë dhe ndërtimi i kolektorit perëndimor nga Kalishta deri në Radozhdë duhet të kishin përfunduar deri në fund të vitit 2017. Për shkak të afateve të shkurtra ndërtimi është prolonguar për periudhën e ardhshme me mjete nga komponenta IPA2.

Rezultatet dalëse:

- Dokumentacioni teknik i nevojshëm i përgatitur në pajtim me standardet e BE (Studim fizibiliteti, Analizë e shpenzimeve dhe përfitimeve, projekte themelore dhe revidim dhe dokumentacion shtesë), dhe
- U organizuan gjashtë takime pune në Strugë, Ohër dhe Shkup me pjesëmarrës nga ekipi i ekspertëve, MAJPH, komunitet e Strugës, Ohrit dhe Vevçanit dhe NNP “Proakva”

Rrugë për këmbësorë dhe biçikleta përreth Liqenit të Ohrit dhe përgjatë rrjedhës së lumit Drini i Zi

- ▶ Qëllimi afatmesëm III nga Programi për zhvillim
- **Masa 3.1.3 Sigurimi i infrastrukturës deri te atraksionet dhe pajisja e tyre**

Qëllimi kryesor i projektit është të japë kontribut në zhvillimin ekonomik të Rajonit përmes zhvillimit të formave alternative të turizmit dhe pasurimit të ofertës turistike përgjatë gjithë vitit, me çka si bazë është marrë Studimi për rrugë për këmbësorë dhe biçikleta në RPJP i përgatitur paraprakisht.

Si rezultate nga aktivitetet e projektit janë përgatitur: Projekti themelor dhe infrastrukturor (me revidim) për ndërtimin e rrugëve të kombinuara për këmbësorë dhe biçikleta, Elaborat për mbrojtjen e ambientit jetësor dhe Elaborat për shënimin e sinjalistikës rrugore. Në projekt janë përcaktuar dhe përfshirë 6 seksione: Ohër-Strugë, HC Shipje-Dibër, Dibër-Ban-



jishtë, Qendër Zhupë-Ishulli i Dibrës, Dibër-Kosovrasti i Poshtëm dhe Qendër Zhupë-Ura e Mellnikut. Gjatësia e përgjithshme e rrugëve të kombinuara sipas projekteve është 31 km, dhe për ndërtimin e të cilave janë të nevojshme 1,7 milion €.

Projekti u financua përmes Skemës për mbështetje financiare të palëve të treta, zbatuar nga GIZ RED Programi me mjete nga BE.

Rezultatet dalëse:

- Dokumentacioni i përgatitur teknik (Projekt themelor dhe infrastrukturor – me revidim - për ndërtimin e rrugëve të kombinuara për këmbësorë dhe biçikleta, Elaborat për mbrojtjen e ambientit jetësor dhe Elaborat për shënimin e sinjalizimit rrugor) për 6 seksione me gjatësi prej 31 km;
- U organizuan tre takime pune në Strugë, Ohër dhe Dibër me përfaqësues të operatorit ekonomik, Qendrës për zhvillim të RPJP, komunat e Strugës, Ohrit, Dibrës dhe Qendër Zhupës, dhe
- Ngjarje promotive e organizuar për prezantimin e rezultateve




Sistem informativ gjeografik – projekt për menaxhim me tokën ndërtimore nga ana e komunave me qëllim tërheqjen e investimeve të huaja

► Qëllimi afatmesëm I nga programi për zhvillim

■ Masa 1.2.1 Mapimi i potencialeve të Rajonit për investime

Qëllimi kryesor i projektit është të rriten investimet e brendshme dhe të huaja në rajonin planor Jugperëndimor përmes krijimit të bazave të të dhënave me lokacionet-parcelat potenciale të tokave ndërtimore, përmes sistemit GIS. Me këtë projekt mundësohet pasqyrimi i plotë i burimeve të disponueshme në të gjitha komunat e rajonit planor Jugperëndimor, me parametra të përcaktuara të qarta të cilat vendosen në shikim për investitorët potencial.

Për ta arritur qëllimin u realizuan katër aktivitete projektuese: Furnizimi i pajisjes harduerike – server rajonal dhe njësi punuese; Furnizimi dhe instalimi i softuerit GIS për server dhe desktop; Realizimi i trajnimit për shfrytëzim të aplikacioneve softuerike për Sistemin informativ gjeografik ESRI produktet – ArcGIS for Server Workgroup Standard dhe ArcGIS for Desktop Standard; Përgatitja e aplikacionit softuerik me bazë të dhënash



për parcelat ndërtimore në nëntë komunat në Rajon dhe vendosja e tyre në pajisje harduerike adekuate (klient + server). Pasi u krijua baza e të dhënave, në pjesën e parë të nëntorit, u organizua ngjarje promovuese me pjesëmarrje të gjashtëdhjetë pjesëmarrësve nga pushteti qendror dhe lokal, agjencitë lokale dhe kombëtare, biznes sektori dhe palë të tjera të interesuara, të cilët treguan interes për bazën e përgatitur.

Projekti u financua përmes Programit për zhvillim të barabartë rajonal të Ministrisë për vetëqeverisje lokale dhe Byrosë për zhvillim rajonal për vitin 2015, ndërsa për trajnimin dhe ngjarjen promovuese me mbështetje financiare nga Zyra e UNDP në Shkup.

Rezultatet dalëse:

- Vendosja e harduerit – serverit rajonal dhe njësisë punuese në ambientet e QZHRPJP;
- Instalimi i softuerit të licencuar GIS-ArcGIS;
- Trajnimi i organizuar për 18 përfaqësues nga komunat për shfrytëzimin e softuerit të licencuar;
- Përgatitja dhe instalimi i aplikacionit me bazë të dhënash, dhe
- Krijimi bazës së të dhënave me attribute për 100 lokacione për investim në nëntë komunat e rajonit planor Jugperëndimor

Ndërtimi i objekteve me efikasitet energjetik dhe shfrytëzimi i burimeve të ripërtërishme të energjisë në rajonin planor Jugperëndimor

► Qëllimi afatmesëm IV nga Programi për zhvillim

■ Masa 4.2.2 Cilësia e ajrit

Zvogëlimi i shfrytëzimit të energjisë elektrike dhe energjisë për ngrohje përmes ndërrimit të dritareve, izolimit të pullazit dhe vendosja e sistemit diellor për përgatitjen e ujit të ngrohtë sanitar është qëllimi kryesor i projektit të realizuar në tri objekte në komunat e Strugës, Dibrës dhe Kërçovës.

Në Strugë në SHFK “Vëllezërit Milladinovci” u realizua ndërrimi i një pjese të dritareve me PVC dritare, dhe u bë rikonstruktimi dhe izolimi i pullazit të sallës së sportit. Në Kërçovë në SHMK “Mirko Mileski”, në disa kate të objektit, u ndërruan një pjesë e dritareve me PVC dritare, ndërsa në Dibër, në SHPAÇF “Breshia” u instalua sistem me kolektorë diellor për ujë të ngrohtë sanitar.

Realizimi i aktiviteteve të projektit, në të tre objektet publike të lartpërmendura në rajon, në masë të madhe do të zvogëlojë shpenzimin e energjisë, me atë edhe harxhimet e këtyre shtëpive arsimore. Gjithashtu, në masë të madhe, do të përmirësohen kushtet e mësimimit në shkollat e



përmendura në Strugë dhe Kërçovë, si dhe kushtet për qëndrim më të mirë ditor të fëmijëve në çerdhen e fëmijëve në Dibër.

Projekti është financuar përmes Programit për zhvillim të barabartë rajonal të Ministrisë për vetëqeverisje lokale dhe Byrosë për zhvillim rajonal për vitin 2015.

Rezultatet dalëse:

- U instalua sistem qendror për përgatitjen e ujit të ngrohtë sanitar në SHPAÇF “Breshia” – Dibër, i përbërë nga 10 kolektorë diellor, dhe dy rezervuar për ujë të ngrohtë prej 1000 dhe 500l;
- Çmontimi i dritareve të reja, montimi i 86 PVC dritareve të reja në SHMK “Mirko Mileski” – Kërçovë dhe SHFK “Vëllezërit Milladinovci” – Strugë, me sipërfaqe të përgjithshme prej 540m²;
- Rikonstruktimi i pullazit dhe vendosja e izolimit të sallës së sportit në SHFK “Vëllezërit Milladinovci” - Strugë, me sipërfaqe të përgjithshme prej 320m²;
- Kushtet e përmirësuara të punës për 1330 shfrytëzues në SHFK “Vëllezërit Milladinovci” - Strugë;
- Kushtet e përmirësuara të punës për 3230 shfrytëzues në SHMK “Mirko Mileski” - Kërçovë;
- Kushtet e përmirësuara të ndejjes dhe punës për 260 shfrytëzues në SHPAÇF “Breshia”, dhe
- Kursim energjie prej 30% në të tre objektet tek të cilat janë bërë ndërhyrjet për efikasitet energjetik



Biznes Qendra – zgjerimi i funksioneve të qendrave për zhvillim të rajoneve planore në drejtim të realizimit të aktiviteteve/shërbimeve për mbështetje të sektorit privat

- ▶ Qëllimi afatmesëm I nga Programi për zhvillim
- **Masa 1.3.3 Shfrytëzimi i programeve për financim në sektorin NVM**

Qëllimi kryesor i projektit është të rritet konkurrenca e rajoneve planore përmes përkrahjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe sipërmarrjes. Në fazën e parë të zbatimit të projektit, që filloi nga fillimi i muajit nëntor 2014 deri në fund të shtatorit të vitit 2015, janë realizuar këto aktivitete:

- Bazë rajonale elektronike e të dhënave për institucione dhe kompani të cilët ofrojnë shërbime për zhvillim të sektorit privat, dhe për “greenfield” dhe “brownfield” lokacionet e disponueshme;
- Takime konsultative me palët e interesuara dhe kërkime në terren gjatë përgatitjes së “Doracaku për investime në rajonin planor Jugperëndimor” me Përmbledhje të zonave të lira industriale dhe Programi për zhvillim të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në rajonin planor Jugperëndimor me Plan aksionar dhe Strategji komunikative;
- Përgatitja e UEB portalit interaktiv për investime në rajon



www.investinsouthwest.mk në të cilin janë futur bazat elektronike e të dhënave të cilat janë krijuar me Doracakun për investime.

- Takime informative në Strugë, në të cilat u prezantuan mundësitë për financim të sektorit privat përmes më shumë programeve nga burimet e financimit kombëtar dhe ndërkombëtar, dhe
- U organizuan dy trajnime nga të cilat njëra në Kërçovë me temë “Programi i BE Horizon 2020 – mjet për konkurrencë” dhe trajnimi i dytë treditur u mbajt në Strugë, i paraparë për përfaqësuesit e komunave për shfrytëzim praktik të ArcGIS softuerit.
- Në fazën e dytë të realizimit të aktiviteteve të projektit e cila filloi në shtator të vitit 2015 deri në fund të vitit:
- U realizua trajnimi për Menaxhim me tokën ndërtimore dhe planifikimin hapësinor, i mbajtur në Kërçovë dhe në të cilën morën pjesë përfaqësuesit e komunave në rajonin planor Jugperëndimor dhe atë të Pollogut.
- Deri në fund të vitit kalendarik u përfunduan aktivitetet përgatitore për Organizimin dhe realizimin e trajnimeve për sipërmarrje, Mapimi i potencialeve për zhvillim të turizmit rural dhe përgatitja e Regjistrimit të potencialeve zhvillimore të turizmit rural.
- Projekti u realizua me mbështetje financiare të Ministrisë për vetëqeverisje lokale dhe Zyrës së Kombeve të Bashkuara UNDP në Shkup.



Rezultatet dalëse:

- Katër takime informative dhe dy trajnime të organizuara për 215 përfaqësues nga biznesi në rajonin planor Jugperëndimor;
- U përgatit dhe u publikua Programi për zhvillim të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në rajonin planor Jugperëndimor me Plan aksionar dhe Strategji komunikuese, në gjuhën maqedonase, shqipe dhe angleze;
- U përgatit dhe u publikua Udhëzuesi për investitorë me Përmbledhje të zonave të lira ekonomike në rajonin planor Jugperëndimor, në tre gjuhë maqedonase, shqipe dhe angleze;
- UEB portal i përgatitur dhe i publikuar për investim në rajon www.investinsouthwest.mk;
- Trajnimi i realizuar për Menaxhim me tokën ndërtimore dhe planifikimin hapësinor, në të cilën në mënyrë aktive morën pjesë 46 pjesëmarrës nga komunat e rajonit Jugperëndimor dhe atij të Pollogut, dhe
- Kushtet e përmirësuara për biznes për 6770 ndërmarrje të vogla dhe të mesme në rajonin planor Jugperëndimor



Përmirësimi i efikasitetit energjetik dhe shfrytëzimi i burimeve të ripërtërishme të energjisë në rajonin ndërkufitar

- ▶ Qëllimi afatmesëm IV nga Programi për zhvillim
- **Masa 4.2.2: Cilësia e ajrit**

Qëllimet kryesore të projektit janë të ndërlidhura me rritjen e shfrytëzimit të burimeve të ripërtërishme të energjisë dhe efikasitetit energjetik në rajonin ndërkufitar që e mbulon, nga njëra anë, rajoni planor Jugperëndimor në Republikën e Maqedonisë, dhe nga ana tjetër, Rajoni i Korçës në Republikën e Shqipërisë.

Aktivitetet e projektit filluan të realizohen kah fundi i vitit 2013 dhe përfunduan në tre mujorin e parë të vitit 2015. Aktiviteti i fundit i planifikuar ishte “Kontrolli energjetik i objekteve publike”, me çka përmes



bashkëpunimit, të të gjithë partnerëve të kyçur në projekt, u përgatit dokumentacion teknik për katër shkolla fillore në komunat e Ohrit, Strugës, Debërcës dhe Qendër Zhupës.

Projekti është financuar nga Bashkimi Evropian si pjesë e IPA Programit për bashkëpunim ndërkufitar në mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë. Partneri kryesor i projektit është “Qendra për efikasitet energjetik në Maqedoni – MACEF” në partneritet me Qendrën për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor nga Republika e Maqedonisë dhe “Albania-EU Qendra për efikasitet energjetik” dhe Këshilli rajonal i Korçës nga Republika e Shqipërisë.

Rezultatet dalëse:

- Kontroll energjetik i realizuar në 4 objekte publike në po aq komuna;
- 4 projekte teknike të përgatitura për përmirësimin e efikasitetit energjetik, dhe
- Dokumentacioni teknik për sipërfaqe prej 3000 m² në 4 objekte publike.



Programi për zhvillim të RPJP 2015-2019

- ▶ Qëllimi afatmesëm II nga programi për zhvillim
- **Masa 2.2.2: Përfshirja e kuadrit lokal të arsimuar dhe profesional në planifikimin dhe krijimin e perspektivave të zhvillimit në Rajon**

Programi për zhvillim i Rajonit planor Jugperëndimor u përgatit në gjysmën e dytë të vitit 2014, në pajtueshmëri me Metodologjinë për përgatitjen e dokumenteve planore. Versioni final i Programit për zhvillim u shqyrtua dhe mori vlerësime pozitive edhe nga ana e Këshillit për zhvillim të barabartë rajonal të Republikës së Maqedonisë. Në seancën e Këshillit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor, e cila u mbajt në 04.02.2016, programi u shqyrtua dhe u miratua. Programi është përkthyer në gjuhën shqipe dhe angleze, nga versionet në të tre gjuhët u botuan një numër i konsiderueshëm.

Përgatitja, përkthimi dhe botimi i Programit për zhvillim të RPJP është mbështetur financiarisht nga GIZ RED.



Rezultatet dalëse:

- versioni final i miratuar i Programit për zhvillim të RPJP 2015-2019 nga ana e Këshillit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor;
- takime pune;
- përkthimi i Programit për zhvillim të RPJP në gjuhën shqipe dhe angleze, dhe
- botimi i Programit në 200 kopje dhe shpërndarja e tyre deri te palët e interesuara





QENDRA PËR ZHVILLIM TË RAJONIT PLANOR JUG-PERËNDIMOR

Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor është një trup profesional për kryerjen e punëve profesionale të një rëndësie për Rajonin, e formuar në bazë të Ligjit për zhvillim të barabartë rajonal (Gaz. Zyrtare e RM 63/2007, 187/2013, 43/2014 dhe 215/2015) dhe Vendimet për themelimin të miratuara nga ana e Këshillave të komunave në kuadër të Rajonit, gjatë vitit 2007 dhe 2008. Me Ligjin dhe Vendimet është përcaktuar fushëveprimi i punës, struktura organizative, si dhe financimi i Qendrës që bëhet duke planifikuar llogari të veçantë në buxhetet e çdo komune, në lartësi prej 10 denarë për kokë banori.

Qëllimi i punës së Qendrës është, që me propozim të komunave dhe palëve të interesuara në kuadër të rajonit, të zhvillojë projekt ide të rëndësishme rajonale, të bëjë formësimin e tyre në propozim projekte konkrete, kërkimi i mjeteve nga burime të jashtme dhe të brendshme, si dhe realizim konkret të projekteve të miratuara.

Nga hapja e Qendrës (korrik i vitit 2009) përfshirë edhe qershorin e vitit 2016 janë realizuar 46 projekte rajonale në vlerë të përgjithshme prej 1.435.000 € nga Programi për zhvillim të barabartë rajonal të MVL dhe BZHR, Programi për zhvillim rural i MBPU dhe donatorë të jashtëm (GIZ dhe UNDP), ndërsa dy projekte të mëdha infrastrukturore në sferën e grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të zeza dhe në sferën e menaxhimit me mbeturinat inerte realizohen me mjete nga BE në vlerë prej 11.000.000 € përmes IPA1 (IPA3 - Zhvillimi rajonal) dhe komponentit IPA2, në bashkëpunim me Ministrinë e ambientit jetësor dhe planifikimit hapësinor.



RAJONI PLANOR JUGPERËNDIMOR

Rajoni karakterizohet me reliefin e tij tipik ku dominojnë malet e reja vargore, me maja të larta, por edhe me fushëgropa nga të cilat më e madhja është ajo e Ohrit-Strugës, në vëllim më të madh e mbushur me Liqenin e Ohrit. Përgjatë rrjedhës së lumit Drin lidhet edhe fushëgropa e Dibrës dhe Zhupës, ndërsa në veri të Ohrit ndodhet Debërca, e cila me majën e lartë Presekë është e ndarë nga fushëgropa e Kërçovës në lindje të së cilës, përgjatë rrjedhjes së lumit Treska, bashkohet edhe zona e Brodit dhe Poreçit, ndërsa në veri Rajoni mbaron me majën e Strazhës.



Në rajonin planor Jugperëndimor bëjnë pjesë 9 komunat në vijim: Komuna e Vevçanit, Komuna e Dibrës, Komuna e Debërcës, Komuna e Ohrit, Komuna e Kërçovës, Komuna e Makedonski Brodit, Komuna e Pllasnicës, Komuna e Strugës dhe Komuna e Qendër Zhupës.



RAJONI PLANOR JUGPERËNDIMOR SIPAS NUMRAVE

Sipërfaqja: 3.340 km², 13.4 % nga territori i përgjithshëm i Maqedonisë
Vendbanime: 286
Numri i komunave: 9
Sipërfaqja pyjore: >16,00%, viti 2015.
Sipërfaqja bujqësore: 133.668 ha, viti 2015.
Tokë punuese: 50.111 ha (37%), viti 2015.
Kullota: 83.552 ha (63%), viti 2015.
Popullsia: 220.065, vlerësim në dhjetor të vitit 2014
Meshkuj: 110.418, Femra: 109.647
Numri i banesave: 84.627, regjistrimi i popullsisë, viti 2002.
Dendësia e popullsisë: 65.8km², viti 2015.
Numri mesatar i personave për familje: 3.8, regjistrimi i popullsisë, viti 2002.
Popullsia e aftë për punë (në moshë prej 15 vjet e më shumë): 181.293, viti 2015.
Shkalla e popullsisë aktive: 54.9, viti 2015.
Shkalla e punësimit: 36.2, viti 2015.
Shkalla e papunësisë: 33.9, viti 2015.
Bruto-paga mesatare për punëtor: 28.930 denarë, viti 2015.
Neto-paga mesatare për punëtor: 19.670 denarë, viti 2015.
PBB për banor: 178.726 denarë, viti 2013.
Numri i shkollave fillore: 123, viti 2015/16.
Numri i shkollave të mesme: 14, viti 2015/16.
Numri i subjekteve afariste aktive: 7.127, (70.139 gjithsej në shtet), viti 2015.
Numri i dhomave: 16.370, viti 2015.
Numri i shtretërve: 41.917, viti 2015.
Numri i turistëve: 298.057, viti 2015.
Numri i bujtjeve: 1.201.927, viti 2015.
Bujtjet mesatare të turistëve në hotele: >2.0, viti 2015.
Rrjeti rrugor lokal: 1.308 km, 2015
Mbeturina komunale të krijuara: 94.391 mijë tonelata, viti 2015.
Mbeturina komunale të grumbulluara: 46.771 mijë tonelata, viti 2015.

PASQYRË TABELARE E AKTIVITETEVE TË REALIZUARA NË VITIN 2015 DHE LIDHJA E TYRE ME PROGRAMIN PËR ZHVILLIM TË RAJONIT PLANOR

Qëllimi afatmesëm	Masa	Lloji i aktivitetit	Numri i aktiviteteve
LRRITJE EKONOMIKE PRIORITETI 1.1 Rritja e konkurrencës në ekonominë rajonale	1.1.1 Lidhja e institucioneve arsimore dhe kërkimore		
	1.1.2 Rritja e kapaciteteve për inovacione të ndërmarrjeve		
	1.1.3 Rritja e kapaciteteve për fondet përkatëse të shtetit dhe BE 1.1.4 Përpërsëritë e investimit në TIK	Takime pune, përgatitja e dokumenteve, propozim-projekte rajonale, prezantime	14
1.2 Tërheqja e investimeve	1.1.5 Brendimi i Rajonit dhe produkteve kryesore të tij 1.2.1 Mapimi i potencialëve të rajonit për investime	Vendim për MTK "Djathi dibran", promovimi i MTK, dorëzimi i vendimit Trajtime, takime pune, mbledhje, pajisje, produkte, promovime	3 8
1.3 Fuqizimi i sektorit NVM	1.2.2 Promovimi i potencialëve ekonomike 1.3.1 Përforcimi i kapaciteteve të NVM 1.3.2 Përkrahje për start-up bizneset		
	1.3.3 Shfrytëzimi i programeve për financim të NVM 1.3.4 Lehtësime për zanatet e vjetra 1.3.5 Mbështetje për paraqitje të përbashkët të kompanive 1.4.1 Përmirësimi i cilësisë dhe ofertës së prodhimeve bujqësore 1.4.2 Krijimi i kushteve për zhvillim rural 1.5.1 Ndërtimi dhe modernizimi i infrastrukturës rrugore 1.5.2 Zbatimi i TIK	Takime pune, trajtime, dokumente strategjike, publikime	14
1.4 Bujqësi dhe zhvillim rural			
1.5 Zhvillimi infrastrukturës transportuese dhe komunikimit			
Gjithsej aktivitetet të realizuara 39			

Qëllimi afatmesëm	Masa	Lloji i aktivitetit	Numri i aktiviteteteve
<p>Qëllimi afatmesëm <u>II. ARSIMI DHE ZHVILLIMI SOCIAL</u> PRIORITETI 2.1 Arsimi cilësor</p>	2.1.1 Promovimi i përparësive të AMP		
	2.1.2 Krijimi i kushteve për paralele për AMP		
	2.1.3 Promovimi i biznesmenëve të suksesshëm		
2.2 Përfshirja në tregun e punës të kategorive në nevojë	2.2.1 Iniciativa për ambiente rurale		
	2.2.2 Përfshirja e kuadrit të ekspertëve në planifikim	Takime pune, konferenca, ngjarje, dokumente, FP të shpallura, prezantime	85
2.3 Programe sociale	2.2.3 Barazi gjinore dhe përfshirje të grupeve të rrezikuara në tregun e punës		
	2.3.1 Rritja e mbulimit të mbrojtjes sociale		
	2.3.2 Përfshirja e fëmijëve në çerdhe në zonat rurale		
	2.3.3 Programe për mbrojtjen e personave në moshë, rrjet për mbrojtje shëndetësore		
Gjithsej aktivitetete të realizuara 85			

Qëllimi afatmesëm	Masa	Lloji i aktivitetit	Numri i aktiviteteteve
III. ZHVILLIMI I TURIZMIT PRIORITETI	3.1.1 Përgatitja e dokumentacionit urbanistik planor	Takime, kërkime në terren, përgatitja e dokumentacionit urbanistik planor për fshatra	4
3.1. Zhvillimi i infrastrukturës	3.1.2 Rrugë malore dhe rrjetëzimi me rajonet tjera		18
	3.1.3 Sigurimi i infrastrukturës deri te atraksionet dhe pajisja e tyre	Takime, kërkime në terren, përgatitja e dokumentacionit teknik, prezantime	
	3.1.4 Info, sinjalizimi dhe vizuelizimi i atraksioneve turistike		
	3.1.5 Revitalizimi dhe ndërtimi i objekteve në zonat rurale		
	3.1.6 Ndërtimi, revitalizimi i shtëpive malore		
3.2 Përforcimi i kapaciteteve për zhvillimin e turizmit	3.2.1 Sistem për organizim turistik të rajonit		
	3.2.2 Trajnime për rritjen e kapaciteteve		
	3.2.3 Përmirësimi i punës së klasterëve dhe shoqatave		
	3.2.4 Vendosja e sistemit për evidentimin e turistëve		
	3.2.5 Krijimi i klimës për PPP		
	3.2.6 Sistem për menaxhim me destin.		
3.3 Krijimi i ofertës turistike rajonale	3.3.1 Përditësimi i hartave turistike		
	3.3.2 Brendimi i rajonit		
	3.3.3 Produkte turistike të përziera		
	3.3.4 Zhvillimi i ofertës gastronomike		
	3.3.5 Prodhime nga turizmi kulturor		
	3.3.6 Rritja e konkurrencës		
	3.3.7 Promovimi i vlerave turistike		
Gjithsej aktivite të realizuara 22			

Qëllimi afatmesëm	Masa	Lloji i aktivitetit	Numri i aktiviteteve
<p>IV MBROJTJA E CILËSISË SË AMBIENTIT JETËSOR</p> <p>PRIORITETI</p> <p>4.1 Ndërtimi, rikonstruktimi dhe modernizimi i infrastrukturës komunale</p>	4.1.1 Rikonstruktimi dhe modernizimi i sistemeve të ujësjellësit	Takime me NPK, përgatitja e lokacioneve, vendosja e platformave hidraulike dhe kontejnerëve nëntokësor	12
	4.1.2 Sistem i integruar për menaxhim me mbeturina inerte	debate publike, takime pune, kërkime në terren, prezantime, dokumente finale të përgatitura	26
	4.1.3 Sisteme për ujëra të zeza komunale	4.2.1 Mbrojtja e biodiversitetit	Sisteme për UNS, ndërtimi i dritareve, rikonstruktimi i pullazit, izolim, objekte me EE
4.2 Mbrojtja e biodiversitetit, ajrit, ujit dhe tokës	4.2.2 Cilësia e ajrit	4.2.3 Mbrojtja e ujit dhe tokës	
Gjithsej aktivite të realizuara 60			

